KOMUNA E JEGUNOVCIT

FLETORJA ZYRTARE
E KOMUNËS SË JEGUNOVCIT

Botohet sipas nevojës	**Numër 5**	**03.12.2025**

JEGUNOVC, D H J E T O R 2025

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Kritereve për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2026

Shpallen Kriteret për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2026, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/1
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të Ligjit për tatimin në pronë („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 61/04, 92/07,102/08,35/11,53/11, 84/12, 188/13, 154/15, 192/15 dhe 23/16) dhe Metodologjisë për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 54/12,17/13,21/13 dhe 142/14) dhe nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së„ nr. 5/02), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 i caktoi çmimet minimale të tokës ndërtimore të caktuara në bazë të çmimeve të arritura në qarkullim në vitin 2025 të cilat do të shfrytëzohen për vlerësimin e pronës së patundshme në Komunën e Jegunovcit dhe zonat për vendbanimet të cilat i përkasin Komunës së Jegunovcit

KRITERET

për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2026

A. TOKA BUJQËSORE

Klasa kad.	KOMUNA KADASTRALE	
	Arrë, kopsht, kopsht pemësh, çmimi den/m²	livadh, vreshta, pyje, kullota etj. çmimi den./m²
1	220	180
2	200	160
3	180	140
4	160	120
5	140	110
6	120	100
7	100	90
8	90	80

B. TOKË NDËRTIMORE

KOMUNA KADASTRALE	Tokë ndërtimore çmimi për m²
Jegunovc , Vratnicë, Podbreg dhe Kopanicë	1000
Zhillçë, Siriçinë, Shemshovë, Prelubishtë, Jançishtë, Staro Sellë, Orashë, Tudencë, Ratajë, Jazhincë, Rogaçevë dhe Raotincë	950
Bellovishtë	900

KOMUNAT KADASTRALE	VENDBANIMET
	Jegunovc, Vratnicë, Zhillçë, Shemshovë, Prelubishtë, Ratajë, Siriçinë, Jançishtë, Kopanicë, Bellovishtë, Podbreg, Raotincë, Tudencë, Jazhincë, Orashë, Rogaçevë dhe Staro Sellë.

B. ZONAT E PËRCAKTUARA

Zonë e caktuar	I përgjigjet zonës nga metodologjia	pika
zonë e I-rë	zona e XV	40

Zonë e caktuar	Vendbanimet
zonë e I-rë	Jegunovc, Vratnicë, Zhillçë, Shemshovë, Prelubishtë, Ratajë, Siriçinë, Jançishtë, Kopanicë, Bellovishtë, Podbreg, Raotincë, Tudencë, Jazhincë, Orashë, Rogaçevë dhe Staro Sellë.

Neni 2

Vlera e tregut e tokës bujqësore,pyjeve dhe kullotave përcaktohet sipas çmimit mestar të shitblerjeve të kryera në vitin paraprak në vitin që i paraprinë për të cilin bëhet vlerësimi i tatimit në pronë

Neni 3

Vlera e tregut e tokës ndërtimore përcaktohet sipas çmimit mestar të shitblerjeve të kryera në vitin paraprak në vitin që i paraprinë për të cilin bëhet vlerësimi i tokës.

Neni 4

Baza tatimore për tatim në qarkullim të pronës së patundshme, baza tatimore për tatim në qarkullim me kontratë për përkujdesje të përjetshme dhe baza tatimore për tatim në trashëgimi dhe dhurata në mes të trashëgimtarëve të brezit të parë dhe të dytë trashëgues zvogëlohet për 50% të shumës së caktuar.

Neni 5

Vlera e tregut e pasurisë së patundshme si vlerë e pasurisë e cila mund të arihet në qarkullimin e lirë në çastin e aritjes së detyrimit tatimor përcaktohet për pasurinë e patundshme në vijim edhe atë:

1. Ndërtesa
a. ndërtesa banesore dhe banesa(bodrume, ballkone, logji dhe taraca)
b. ndërtesa afariste dhe lokale afariste,
c. ndërtesa afariste dhe hapësira afariste
d. ndërtesa dhe banesa për pushim dhe rekrejim

2. Toka
a. bujqësore
b. ndërtimore pyje dhe
c. kullota.

3. Objekte tjera ndërtimore
a. garazhe
b. objekte ndihmëse (hambarë, stalla, kasolla).
c. pasuri tjetër të patundshme.

Neni 6

Vlera e tregut e pasurisë së patundshme nga neni 5 i këtyre Kritereve përcaktohet me pika përllogaritës për m² sipërfaqe funksionale për ndërtesat dhe objektet e tjera ndërtimore dhe për metër 2 për sipërfaqe të tokës, varësisht nga lloji i pronës dhe sipas elementeve shtesë themelore dhe plotësuese të përfshirë në këto kritere dhe në formularët të cilët janë pjesë e kësaj metodologjie.

Neni 7

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore kolektive përllogaritet si mbledhje e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logji dhe 30% të sipërfaqeve të bodrumit.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore kolektive e cila gjendet në nënkulm paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logji dhe 30% të sipërfaqeve të bodrumit.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore individuale (shtëpi) paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logjive.

Sipërfaqja funksionale e një banese në ndërtesat banesore individuale(shtëpi) e cila gjendet në nënkulm paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë në muret e brendshme të dhomave dhe korridoreve të rritur për 25% nga sipërfaqja e tarracave, 50% nga sipërfaqja e ballkoneve, 75% të sipërfaqeve të logjive.

Sipërfaqja funksionale e bodrumit dhe suterenit në ndërtesat banesore individuale(shtëpi) paraqet mbledhjen e sipërfaqeve shfrytëzuese të dyshemesë ndërmjet mureve të brendshme.

Sipërfaqja funksionale përcaktohet sipas dokumentacionit gjegjëse por nëse të tillë nuk ka atëherë me matje.

Neni 8

Kriteret për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit hynë në fuqi në ditë e shpalljes në „ Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit''.

Nr. 08-2530/3
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit

Shpallet Vendimi për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/2
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/25) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori:

V E N D I M

për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit

Neni 1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit lejon furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit.

Furnizimi nga paragrafi 1 i këtij neni do të bëhet me mjete nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit në pajtim me Ligjin për furnizime publike.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-2530/4
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për lidhjen e marrëveshjes për koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe përcaktimin e shumës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse

Shpallet Vendimi për lidhjen e marrëveshjes për koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe përcaktimin e shumës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/3
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36, paragrafi 1, pika 3 e Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare e RM, nr. 5/02 dhe Gazeta Zyrtare e RMV, nr.202/24) dhe nenit 21, paragrafi 1, pika 5 e Statutit të Komunës së Jegunovcit (Gazeta Zyrtare e Komunës së Jegunovcit, nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit, në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 , miratoi:

VENDIM

Për lidhjen e marrëveshjes për koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe përcaktimin e shumës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse

Neni 1

Me këtë Vendim, Kryetari i Komunës së Jegunovcit autorizohet të lidhë marrëveshje për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse me koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit.

Neni 2

Për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse, koncesionarëve u caktohet tarifë prej 20.000,00 denarë në muaj.

Mjetet nga paragrafi 1 i këtij neni do të ndahen për ndërtimin e rrugëve dhe rrugicave lokale në vendbanimet ku ndodhet fusha e eksploatimit të koncesionarëve.

Të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella ndërmjet Komunës dhe koncesionarëve do të rregullohen me lidhjen e një marrëveshjeje.

Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-2530/5
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për përcaktimin e kompensimit gjatë ndërtimit të objekteve familjare dhe afariste, objekteve në linjë dhe të infrastrukturës si edhe të objekteve të tjera

Shpallet Vendimit për përcaktimin e kompensimit gjatë ndërtimit të objekteve familjare dhe afariste, objekteve në linjë dhe të infrastrukturës si edhe të objekteve të tjera, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/4
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 5/02 dhe „Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 13 të Statutit të Komunës së Jegunovcit („Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit '' nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e katërt të mbajtur më 02.12.2025,miratoi

V E N D I M

Për përcaktimin e kompensimit gjatë ndërtimit të objekteve familjare dhe afariste, objekteve në linjë dhe të infrastrukturës si edhe të objekteve të tjera

Neni 1

Për ndërtimin e objekteve individuale dhe objekteve të tjera të cilat ndërtohen në tokën ndërtimore të përfshirë me dokumentacionin planor urbanistik ku nuk është siguruar tërësisht rregullimi i tokës ndërtimore,paguhet kompensim prej 360 denarë/m2,i cili paraqet bazë për llogaritje,respektivisht koeficient 1.0 për sipërfaqe neto ndërtimi.

Neni 2

Për ndërtimin e hapësirave afariste në objektin banesor dhe jashtë tij,si edhe për të gjitha objektet të cilat i shërbejnë objektit afarist i cili do të ndërtohet në tokën ndërtimore paguhet kompensim nga neni 1 i këtij Vendimi të shumëzuar me koeficientin 1.5 respektivisht 540,00 den/m2

Për ndërtimin e objekteve për :

-Garazhe në kate
-Industria e rëndë dhe ndotëse
-Industria e lehtë dhe jo ndotëse
-Servise
-Vend shkarkime

do të paguhet kompensim prej 6.000,00 den/m2.

Për ndërtimin e:

-komplekseve hoteliere dhe turistike
-hotele dhe motele
-Shtëpi të malorëve

do të paguhet kompensim në shumë prej 3.500,00 den/m2

Për ndërtimin e objekteve të gjuetarëve,malore dhe objekteve të tjera në pronësi të organizatave jo fitim prurës do të paguhet kompensim në shumë prej 2.000,00 den/m2.

Neni 3

Për ndërtimin,mbindërtimin dhe rindërtimin e objekteve paguhet kompensim në lartësi prej 50% nga vlera e përcaktuar në nenet 1 dhe 2 të këtij Vendimi.

Me aneks ndërtim dhe mbindërtim sipas nenit 1 të këtij Vendimi,nënkuptohet fitimi i çdo sipërfaqe të re të arritur me ndërtimin e pjesës së re të objektit në vijë horizontale dhe vertikale ose me mbylljen e sipërfaqeve të ndara të objektit,por që të mos paraqesin më shumë se 50% të sipërfaqes ekzistuese dhe të mos jenë tërësi e vetme funksionale.

Neni 4

Për ndërtimin e objekteve në linjë dhe të infrastrukturës paguhet kompensim në shumë prej:

-për vendosjen e antenave me pajisje përcjellëse radio shpërndarëse dhe telekomunikative e të tjera (stacione bazë) .....60.000,00 denarë/njësi,

-për vendosjen e shtyllës së transformatorit ..... 40.000,00 denarë/njësi,

- për vendosjen e paneleve fotovoltaike për prodhimin e energjisë elektrike me instalimin e kapacitetit maksimal deri më 1 MW nuk paguhet kompensim për rregullimin e tokës ndërtimore

-Për vendosjen e trafostacionit të vogël,nga betoni ose me mur deri 12 m2.....60.000,00 den/njësi,

-Për vendosjen e shtyllës nga druri,betoni i armuar dhe shtyllë tjetër deri 1 m2 ....3.000,00 den/njësi,

-Për vendosjen e shtyllave me grila për larg përçues 5.000,00 den/m2,

-Hapja e gropës për vendosjen infrastrukturës nëntokësore deri 5 km 250 den/m1,

-Hapja e gropës për vendosjen infrastrukturës nëntokësore mbi 5 km 200 den/m1,

-Trase për vendosjen e përçues ajror për infrastrukturë mbi tokësore deri 1 km...,200 denarë/m1.

-Trase për vendosjen e përçues ajror për infrastrukturë mbi tokësore mbi 1 km...,150 denarë/m1.

Neni 5

Ndërtimi i cisternave për deponimin e karburantit ..... 70% të çmimit të vërtetuar për hapësirë afariste.

Neni 6

Ndërtimi i pishinave të hapura,të mbyllura dhe të kombinuar dhe peshkatore .....70 % nga çmimi i përcaktuar për objekt afarist.

Neni 7

Përllogaritja e hapësirës së shfrytëzueshme për pagesën e kompensimit për rregullimin e tokës ndërtimore do të përllogaritet sipas koeficientëve në vijim:

1 Objekte afariste dhe publike

-hapësira afariste	1.0
-depo në katin përdhes në funksion të objektit afarist (dyqan),repart prodhimi	1.0
-Suteren	1.0
-Galeri me lartësi mbi 4,50	1.4
-depo dhe lokale të tjera në bodrum	0.5
-garazhe në bodrum	0.1
-garazhe në katin përdhes	1.0
-trafostacion deri 35 kv në objekt dhe jashtë objektit	0.4
-trafostacion mbi 35 kv	1.0
-hapësira shkallësh dhe komunikime të përbashkëta	0.5
-lozhë e mbyllur nga tri anë	0.5
-mbështetëse e mbyllur në 2 anë	0.3
-ballkon,tarraca	0.4
-hapësirë e mbi mbuluar e hapur (nën strehë)	0.3
-hapësira ndihmëse,vend për lëndë djegëse,vend për kazanë	0.3
-objekt në lartësi mbi 32 kate	0.27
-parkingje	0.10

2 Objekte të tjera

-Garazhe në kate	0.05
-objekte të mbuluara sportive	0.5
-objekte sportive të zbuluara	0.3
-stacione gazi dhe stacione bazë për 50% nga sipërfaqja e lokacionit	1.0
-tregje të hapura-për 30% nga sipërfaqja e lokacionit	1.0
-pishina	0.2
-trafostacione mbi 35 kv	1.0
-Agro berza	0.5
-Qendra blerëse dhe shpërndarëse ose tregje	0.5

3 Për objekte nga grupi i klasave për qëllime G-prodhimi,shpërndarja dhe servise

-G1 industrija e rëndë dhe ndotëse	0.05
-G2 industri e lehtë dhe jo ndotëse	0.05
-G3 servise	0.05
-G4 vendshkarkim	0.05

4 Për pika karburanti dhe për përmbajtjet e tyre (shitore,kafiteri dhe restorante, auto servise,auto sallone,hapësira ndihmëse

-hapësira shitëse të pikave të karburantit	1.0
-hapësira shërbyese të pikave të karburantit	1.0

5. Për objekte nga grupi i klasit për qëllime B5 dhe A4

-komplekse hoteliere dhe turistike	0.05
-komplekse hoteliere dhe pushimore	0.05
-hotel	0.05
-motel	0.05
-shtëpi malorësh	0.05
-shtëpi të gjuetarëve	0.05

6. Për objekte nga grupi i klasit për qëllime E (E1 dhe E2)-Infrastrukturë

-E1 Infrastrukturë komunale (gypa sjellës,instalime për kabllo për energji elektrike,kabllo optike etj.	1.5
-E2 Suprastrukturë komunale (terminale të secilit lloji, aeroporte, vendkalime kufitare,stacione të pompave të benzinës, stacione matëse, trafostacione deri 20 kv, ndërtime për prodhimin e energjisë, rezervuare për ujë, shtëpi zjarrfikësish, etj.)	1.5

Neni 8

Ky Vendim u përket të gjitha vendbanimeve të Komunës së Jegunovcit.

Neni 9

Kërkuesit e lejes për ndërtim sipas këtij Vendimi shumën duhet ta paguajnë në xhiro llogarinë Llogaria e thesarit 100000000063095,llogari pagese e Buxhetit të Komunës së Jegunovcit 840-131-06511,shifra e të ardhurave 717137-00 me qëllim dërgimi për rregullimin e tokës ndërtimore.

Neni 10

Me hyrjen në fuqi të këtij Vendimi dhe zbatimit të tij ndërpritet të vlejë Vendimi i Këshillit të Komunës së Jegunovcit nr.08-1081/10 të datës 03.07.2014 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 17/2014), nr.08-631/6 të datës 15.05.2019 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 21/2019) dhe nr. 08-296/3 të datës 15.02.2024 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 35/2024).

Zgjidhja e lëndëve të filluara para ditës së fillimit të zbatimit të këtij vendimi , do të vazhdojnë në pajtim me dispozitat e Vendimit të miratuar nga këshilli nr. 08-1081/10 të datës 03.07.2014 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 17/2014), nr.08-631/6 të datës 15.05.2019 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 21/2019) dhe nr. 08-296/3 të datës 15.02.2024 („Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit „nr. 35/2024).

Ky vendim hyn në fuqi në ditë e shpalljes në „Fl. zyrtare e Komunës së Jegunovcit„ kurse do të zbatohet nga 01.01.2026.

Nr. 08-2530/6
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

AKTVENDIM

për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026

Shpallet Vendimi për dhënie pëlqim Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/5
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe ‘’ Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori

V E N D I M

për dhënie pëlqim Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026

Neni 1

Me këtë Vendim Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026 me nr. 02-638/3, të cilën Këshilli drejtues i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc e mori me datë 26.11.2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-2530/7
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për transferimin e mjeteve-subvencioneve nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026

Shpallet Vendimi për transferimin e mjeteve-subvencioneve nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025.

Nr. 09-2569/6
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 15 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe të nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 miratoi:

V E N D I M

për transferimin e mjeteve-subvencioneve nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026

Neni 1

Nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit , Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc do ti transferohen mjete financiare-subvencione për vitin 2026 në zërin 461130-Programa AO dhe J1 dhe zëri 464990-Programi A0.

Mjetet financiare do të transferohen Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc në vitin 2026 sipas mundësive financiare të komunës dhe nevojave të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc.

Neni 2

Mjetet që do të transferohen në bazë të këtij Vendimi janë të pakthyeshme për mbulimin e të dalave për mirëmbajtje rrjedhëse, subvencionim, shërbime komunale dhe të dala të tjera dhe të njëjtat do të shfrytëzohen racionalisht dhe ekonomikisht për funksionim normal të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc, pas kërkesës së dorëzuar paraprakisht për lejimin e mjeteve financiare.

Neni 3

Mjetet në nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit për vitin 2026 do të transferohen për Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc në xhiro-llogari nr 290 00000 24040-02, NVT 4055021501658, deponues TTK Banka SHA Shkup.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

Nr. 08-2530/8
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Shpallet Vendimi për dhënie pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/7
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe ‘’ Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori

V E N D I M

për dhënie pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Neni 1

Këshilli i Komunës së Jegunovcit jep pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc me nr. 02-638/4, të cilën Këshilli drejtues i Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc e mori me datë 26.11.2025.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-2530/9
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Shpallet Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/8
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe ‘’ Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori

V E N D I M

për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc

Neni 1

Me këtë Vendim vazhdohet mandati i:

- anëtarëve të Këshillit drejtues të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc , të emëruar me Vendim nr. 08-1556/16 të datës 30.11.2021;
- anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc, të emëruar me Vendim nr. 08-1556/17 të datës 30.11.2021.

Neni 2

Mandati i anëtarëve aktual të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc,vazhdohet jo më gjatë se 6 muaj nga dita e përfundimit të mandatit, (mandati ka përfunduar më 30.05.2025).

Neni 3

Procedura për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës do të realizohet pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi , por jo më gjatë se periudha e vazhdimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc .

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-2530/10
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit

Shpallet Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/9
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe ‘’ Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori

V E N D I M

për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës “Светлина”-“Drita” f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit

Neni 1

Me këtë Vendim vazhdohet mandati i anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës “Светлина”-“Drita” f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit, të emëruar me Vendim nr. 08-1556/14 të datës 30.11.2021.

Neni 2

Mandati i anëtarëve aktual të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës “Светлина”-“Drita” f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit,vazhdohet jo më gjatë se 6 muaj nga dita e përfundimit të mandatit, (mandati ka përfunduar më 30.05.2025).

Neni 3

Procedura për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit drejtues do të realizohet pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi , por jo më gjatë se periudha e vazhdimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës “Светлина”-“Drita” f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-2530/11
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 3 lidhur me nenin 62 paragrafi 4 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/2002 dhe "Gazeta zyrtare e RMV-së" nr. 202/24) dhe nenit 39 paragrafi 1 neni 54 lidhur me nenin 53 paragrafi 3 të Statutit të Komunës së Jegunovcit ("Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit" nr. 21/03), kryetari i Komunës së Jegunovcit ,mori:

A K T V E N D I M

për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit

Shpallet Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit, që Këshilli i Komunës së Jegunovcit e miratoi në mbledhjen e mbajtur më 02.12.2025

Nr. 09-2569/10
03.12.2025
Jegunovc

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 36 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (‘’ Gazeta zyrtare e RM-së’’ nr. 5/02 dhe ‘’ Gazeta zyrtare e RMV-së’’ nr. 202/24) dhe nenit 21 paragrafi 1 pika 43 të Statutit të Komunës së Jegunovcit (‘’Fletorja zyrtare e Komunës së Jegunovcit ‘’ nr. 21/03), Këshilli i Komunës së Jegunovcit në mbledhjen e pestë të mbajtur më 02.12.2025 ,mori

V E N D I M

për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit

Neni 1

Me këtë Vendim vazhdohet mandati i anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit, të emëruar nga ana e themeluesit me Vendim nr. 08-1556/15 të datës 30.11.2021.

Neni 2

Mandati i anëtarëve aktual të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit, të emëruar nga themeluesi, vazhdohet jo më gjatë se 6 muaj nga dita e përfundimit të mandatit, (mandati ka përfunduar më 30.05.2025).

Neni 3

Procedura për emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit drejtues do të realizohet pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi , por jo më gjatë se periudha e vazhdimit të mandatit të anëtarëve aktual të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit.

Neni 4

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes në ‘’Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit’’.

Nr. 08-2530/12
02.12.2025
Jegunovc

KËSHILLI I KOMUNËS SË JEGUNOVCIT
Kryetar
Marija Rafajllovska, d.v,

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gaz. zyrtare e RM„ nr. 5/02 dhe „Gaz. zyrtare e RM„ nr. 202/24), neni 48 të Ligjin për entet ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 32/05,120/05 dhe 51/11) kurse në pajtim me nenin 116 paragrafi 1 alineja 1 të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 161/2019,229/2020, 3/2025 dhe 74/25), kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 17.11.2025, mori:

AKTVENDIM
për shkarkim nga funksioni Drejtor i Shkollës fillore komunale SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc

1. **Burhan Ejupi** i lindur më 15.01.1976 në Tetovë me vendbanim në f. Shemshovë rr.101 nr. pn me NVAQ 1501976470152, **shkarkohet** nga funksioni drejtor i Shkollës fillore komunale SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc, përfundimisht me datën 17.11.2025 për arsye të dorëzimit të shkresës për dorëheqje nga funksioni i drejtorit.

2. Me hyrjen në fuqi të këtij Aktvendimi ndërpritet të vlejë Aktvendimi i Kryetarit të Komunës së Jegunovcit nr. 09-189/3 të datës 07.02.2025 me të cilin personi nga pika 1 e këtij Aktvendimi ishte emëruar drejtor i SHFK SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

A r s y e t i m

Burhan Ejupi me Aktvendim të kryetarit të Komunës së Jegunovcit nr. 09-189/3 të datës 07.02.2025 ishte emëruar drejtor i SHFK SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc, me mandat prej 4 vjetëve.

Burhan Ejupi deri te Kryetari i Komunës së Jegunovcit ka dorëzuar shkresë për dorëheqje nga funksioni i drejtorit dhe i njëjti do të shpërndahet në vendin e punës të cilin është shpërndarë para se të emërohet në funksionin e drejtorit.

Nga arsyet e përmendura më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Ankesa eventuale e dorëzuar kundër këtij Aktvendimi nuk e shtyn realizimin e tij.

Aktvendimi hyn në fuqi ditën e marrjes.

Udhëzim juridik Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditëve nga dita e pranimit të Aktvendimit nëpërmjet kryetarit të Komunës së Jegunovcit deri tek Komisioni i shkallës së dytë kompetente për vendosje për çështje administrative dhe çështje nga lëmia e marrëdhënieve në punë dhe mbikëqyrjes inspektuese të shkallës së dytë.

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetar
Dimitar Kostadinoski d.v

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 9 të Ligjit për vetëqeverisje lokale („Gaz. zyrtare e RM„ nr. 5/02 dhe „Gaz. zyrtare e RM„ nr. 202/24), neni 48 të Ligjin për entet ("Gazeta zyrtare e RM", nr. 32/05,120/05 dhe 51/11) kurse në pajtim me nenin 118 paragrafi 1 dhe 4 të Ligjit për arsimin fillor ("Gazeta zyrtare e RMV", nr. 161/2019,229/2020, 3/2025 dhe 74/25), kryetari i Komunës së Jegunovcit më datë 18.11.2025, mori:

A K T V E N D I M
për emërimin e ushtruesit të detyrës Drejtor të Shkollës fillore komunale SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc

1. **Argjend Aliti** i lindur më 20.08.1983 në Tetovë , me vendbanim në f. Shemshovë rr.101 nr.pn me NVAQ 2008983470023 me arsim të kryer ASP – Fakulteti i kulturës fizike – Profesor i diplomuar i arsimit fizik dhe shëndetësor , i punësuar në kohë të pacaktuar në SHFK SHEMSHOVA nga f. Shemshovë Jegunovc në vendin e punës mësues i arsimit fizik dhe shëndetësor, **emërohet për ushtrues detyre Drejtor** i SHFK SHEMSHOVA nga f. Shemshovë Jegunovc .

2. Ushtruesi i detyrës nga pika 1 e këtij Aktvendimi do ti kryejë punët pa ndërprerë **duke filluar nga 18.11.2025** deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij, dhe për këtë periudhë kohore vendi i punës do ti pushojë.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes, do të zbatohet prej 18.11.2025 dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

A r s y e t i m

Nga radhët e të punësuarve në SHFK SHEMSHOVA nga f. Shemshovë Jegunovc , Argjend Aliti i punësuar në kohë të pacaktuar në vendin e punës mësues i arsimit fizik dhe shëndetësor, emërohet ushtrues detyre Drejtor i SHF" Aleksandar Zdravkovski'' nga f. Jegunovc

Ushtruesi i detyrës nga pika 1 e këtij Aktvendimi do ti kryejë punët pa ndërprerë duke filluar nga 18.11.2025 deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e emërimit të tij, dhe për këtë periudhë kohore vendi i punës do ti pushojë.

Nga arsyet e përmendura më lartë u vendos si në dispozitivin e këtij Aktvendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi në ditën e shpalljes kurse do të zbatohet nga 18.11.2025.

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh nga dita e Aktvendimit të kryetarit të Komunës deri te Komisioni i shkallës së dytë kompetente për vendosje për çështje administrative dhe çështje nga lëmia e marrëdhënieve në punë dhe mbikëqyrjes inspektuese të shkallës së dytë.

KOMUNA E JEGUNOVCÎT
Kryetari
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale (" Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 5/02), neni 120 paragrafi 9 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (" Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe " Gazeta zyrtare e RMV-së'' 104/19 , 146/19, 275/19, 311/20, 294/21 ,150/22 dhe 236/22) dhe nenit 41 paragrafi 1 alineja 6 të Statutit të IPKKF MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit nr. 01-2/3 të datës 31.08.2016 kryetari i Komunës së Jegunovcit më 01.12.2025, mori:

A K T V E N D I M

për shkarkimin e ushtruesit të detyrës Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit

1. Maja Vasovska Nikollovski shkarkohet nga detyra ushtrues detyre - Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit përfundimisht me 30.11.2025.

2. Personi nga pika 1 e këtij Aktvendimi ishte emëruar ushtrues detyre - Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit për periudhën 31.05.2025 deri më 30.11.2025.

3. Në ditën e hyrjes në fuqi të këtij Aktvendimi përfundoi të vlejë Aktvendimi nr. 03-2321/1 të datës 02.12.2024.

4. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetar
Dimitar Kostadinoski,d.v.

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1 pika 16 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 5/02), neni 126 të Ligjit për mbrojtjen e fëmijëve (" Gazeta zyrtare e RM-së'' nr. 23/13, 12/14, 44/14, 144/14, 10/15, 25/15, 150/15, 192/15, 27/16, 163/17, 21/18, 198/18 dhe " Gazeta zyrtare e RMV-së'' 104/19 , 146/19, 275/19, 311/20, 294/21 , 150/22 dhe 236/22) dhe nenit 44 të Statutit të IPKKF MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit nr. 01-2/3 të datës 31.08.2016 kryetari i Komunës së Jegunovcit më 01.12.2025, mori:

A K T V E N D I M

për vazhdimin e mandatit të ushtruesit të detyrës Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc

1. Maja Vasovska Nikollovski e lindur më 02.01.1984 në Tetovë, me vendbanim në Prelubishtë rr. 101 nr. pn Komuna e Jegunovcit , me NVAQ 0201984475018 dhe nr. l.nj. A1717054 e lëshuar nga MPB Tetovë, Arsim të lartë të mbaruar shkalla VII/1, Fakulteti Pedagogjik, mësimit parashkollor, e punësuar në Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc në vendin e punës Edukatore e fëmijëve të moshës mbi 2-6 vjeç, me titull praktikant, e emëruar për U.D. Drejtor me Aktvendim nr. 09-1242/1 të datës 30.05.2025 për periudhë prej 6 muajsh prej 31.05.2025 deri më 30.11.2025, i vazhdohet mandati ushtrues detyre - Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit duke filluar nga 01.12.2025

2. Ushtruesi i detyrës - drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit do t'i kryejë punët deri në emërimin e drejtorit të ri, por jo më gjatë se gjashtë muaj nga dita e vazhdimit të mandatit.

3. Ky Aktvendim hyn në fuqi ditën e marrjes dhe do të shpallet në "Fletoren zyrtare të Komunës së Jegunovcit".

KOMUNA E JEGUNOVCIT
Kryetar
Dimitar Kostadinoski,d.v.

P ë r m b a j t j a

Aktvendimi për shpalljen e Kritereve për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2026;.....1
Kriteret për caktimin e vlerës së tregut për pronën e patundshme në Komunën e Jegunovcit për vitin 2026;.....2

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit;.....5
Vendimi për miratimin e mjeteve financiare për furnizimin e automjetit zjarrfikës për nevojat e Komunës së Jegunovcit;.....6

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për lidhjen e marrëveshjes për koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe përcaktimin e shumës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse;.....7
Vendimi për lidhjen e marrëveshjes për koncesionarët që veprojnë në territorin e Komunës së Jegunovcit dhe përcaktimin e shumës së kompensimit për shfrytëzimin e rrugëve lokale qasëse;.....8

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për përcaktimin e kompensimit gjatë ndërtimit të objekteve familjare dhe afariste, objekteve në linjë dhe të infrastrukturës si edhe të objekteve të tjera;.....9
Vendimi për përcaktimin e kompensimit gjatë ndërtimit të objekteve familjare dhe afariste, objekteve në linjë dhe të infrastrukturës si edhe të objekteve të tjera;...10

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026;.....15
Vendimi për dhënie pëlqim Vendimit për përcaktimin e lartësisë së vlerës së pikës së pagave për të punësuarit e Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026;.....16

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për transferimin e mjeteve-subvencioneve nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026;.....17
Vendimi për transferimin e mjeteve-subvencioneve nga Buxheti i Komunës së Jegunovcit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f.Jegunovc, Jegunovc për vitin 2026;.....18

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për dhënie pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc;.....19
Vendimi për dhënie pëlqim Vendimit Statutar për ndryshimin dhe plotësimin e Statutit të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc;.....20

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc ;.....21
Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues dhe Këshillit mbikëqyrës të Ndërmarrjes publike komunale për kryerjen e punëve botore JEGUNOVCI f. Jegunovc, Jegunovc ;.....22

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit;.....23
Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit Drejtues të Institucionit publik Lokal-Bibliotekës "Светлина"-"Drita" f. Prelubishtë-Komuna e Jegunovcit;.....24

Aktvendimi për shpalljen e Vendimit për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit;.....25
Vendimi për vazhdimin e mandatit të anëtarëve të Këshillit drejtues të Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit;.....26

Aktvendimi për shkarkim nga funksioni Drejtor i Shkollës fillore komunale SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc.....27
Aktvendimi për emërimin e ushtruesit të detyrës Drejtor të Shkollës fillore komunale SHEMSHOVA f. Shemshovë Jegunovc.....28

Aktvendimi për shkarkimin e ushtruesit të detyrës Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT f. Jegunovc Komuna e Jegunovcit.....29
Aktvendimi për vazhdimin e mandatit të ushtruesit të detyrës Drejtor i Institucionit publik komunal për fëmijë-Kopshti i fëmijëve MOLLËZAT Komuna e Jegunovcit, Jegunovc.....30